



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar më datë 16.12.2022 ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr.62/2 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurit **Altin Hajri**, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “*Rrëmbim apo mbajtje peng e personit*” kur është shkaktuar vdekja, parashikuar nga nenet 109 paragrafi i tretë dhe 28/4 të Kodit Penal, “*Mbajtje pa leje e armëve luftarake*”, parashikuar nga nenet 278 paragrafi i parë dhe 28/4 i Kodit Penal, “*Fshehja dhe asgjesimi i kufomës*”, parashikuar nga nenet 303 dhe 28/4 i Kodit Penal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a/2 dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 334/1 e 334/3 i Kodit Penal”.

2. Në seancën e datës 10.09.2024, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (seanca paraprahe) me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Etleva Deda, pasi shqyrtoi pretendimet e palëve, me vendimin **Nr. 5/25/146**, datë **10.09.2024** vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.
2. Dërgimin për gjykim të procedimit penal nr.62/2 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në ngarkim të të pandehurit **Altin Hajri**, i akuzuar për kryerjen e veprave penale “*Rrëmbim apo mbajtje peng e personit*” kur është shkaktuar vdekja, parashikuar nga nenet 109 paragrafi i tretë dhe 28/4 të Kodit Penal, “*Mbajtje pa leje e armëve luftarake*”, parashikuar nga nenet 278 paragrafi i parë dhe 28/4 i Kodit Penal, “*Fshehja dhe asgjesimi i kufomës*”, parashikuar nga nenet 303 dhe 28/4 i Kodit Penal, “*Grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 333/a/2 dhe “*Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal*”, parashikuar nga neni 334/1 e 334/3 i Kodit Penal, **trupit gjykues të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar**.
3. Së bashku me aktet e këtij procedimi penal dërgohet dhe kërkesa e të pandehurit Altin Hajri për aplikimin e gjykimit të posaçëm, atë të shkurtuar.

4. Fashikulli i gjykimit përmban të gjitha aktet e kryera gjatë hetimit paraprak të procedimit penal nr.62/2 të vitit 2020 të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, të paraqitura nga prokurori në gjykatë, si dhe ato marra në seancë paraprake.
5. Kundër këtij vendimi, për dërgimin e çështjes në gjyq, nuk lejohet ankim.
6. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Tiranë, më datë 10.09.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar